

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me zyrtarin ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.A., nga fshati ..., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit, av.S.M., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.246/2018, të dt.12.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.A., av.S.M., kurse Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.246/2018, të dt.12.11.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.246/2018, të dt.12.11.2018, është shpallur fajtor i akuzuari R.A., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë, në shumën prej 450(katërqindpesëdhjetë)Euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që të paguajë në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë në kuptim të nenit 46 par.3 të KPK, do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 22(njëzetedy)ditëve, duke llogaritur çdo ditë të kaluar në burg nga 20Euro.

Në kuptim të nenit 69 të KPK, i shqiptohet dënimi plotësues marrja e pistoletës e markës "HS" modeli "XDM9", kl.9mm, prodhim kroat, me numër serik H199692, një karikator i të njëjtës armë dhe 11 fishek të tipit "Luger", kal.9mm, kurse urdhërohet që arma e konfiskuar të shkatërrohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20Euro, paushallin gjyqësor në shumën prej 20Euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30Euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit R.A., av.S.M., për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket masës plotësuese për marrjen e armës.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.54/2019, të datës 21.01.2019, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit R.A., av.S.M., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.A., av.S.M., nuk është e bazuar

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzohin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av.S.M., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se nga kjo çështje penale i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, mirëpo, gjykata e shkallës së parë, është dashur që të ketë parasysh që i akuzuari posedonte lejen e organit zyrtar, për mbajtje, mirëpo, e njëjta ishte skaduar, se i akuzuari asnjëherë nuk e ka keqpërdorë të njëjtën, se nuk respektuar afatin për zgjatjen e lejes për mbajtjen e armës, andaj, dënimi plotësues i shqiptuar për konfiskimin e së njëjtës është i ashpër dhe se të akuzuarit duhet ti kthehet arma e konfiskuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i akuzuari është penduar për kryerjen e veprës penale dhe se më parë nuk ka ra në kundërshtim me ligjin, se ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me kryer vepra penale të tjera apo të llojit të njëjtë, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, ashtu që në kuptim të dispozitës ligjore përkatëse, e pas vlerësimit të ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, nga e cila nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate erdhi në përfundim se vendimi për dënimin e shqiptuar, si dhe dënimin plotësues kanë mbështetjen e duhur ligjore, andaj, në prani të këtyre rrethanave kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.32/2019, të datës 06.02.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Shqipe Qerimi